



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SKRAPAR  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR. 114 Datë 14 .11.2018

**MBI DHËNIEN E PAGESAVE PËR AFTËSINË E KUFIZUAR PËR MUAJIN  
DHJETOR 2018**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe në nenin 7 dhe nenin 29 pika 2 të ligjit 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar; VKM nr.618 datë 07.09.2006 "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të masës së pagesës për personat me aftësi të kufizuar", i ndryshuar; Udhëzim nr. 366, datë 21.9.2017 "Mbi zbatimin e vendimit nr. 618, datë 07.09.2006, të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kritereve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", ligjin nr. 8089, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit" i ndryshuar, VKM nr. 277 datë 18.06.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit" Udhëzimin nr. 367, datë 21.09.2017 "Mbi zbatimin e Vendimit Nr.277, të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga Statusi i të Verbërit", i ndryshuar, Ligjin nr. 8626, datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", VKM nr. 31, datë 20.01.2001 "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" i ndryshuar; Udhëzimin nr. 365 datë 21.09.2017 "Mbi zbatimin e Vendimit Nr.31, datë 20.01.2001, të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik" i ndryshuar, VKM nr. 869, datë 18.06.2008 "Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Statusi i invalidit".

Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim materjalin e përgatitur nga Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë

**V E N D O S I :**

1. Pëfitojnë pagesë paaftësie për muajin Dhjetor 2018 në total 533 persona me 6 585 640 lekë, të ndarë në:

- Të paaftë 263 persona me fond 2 803 640 lekë në muaj
- Kujdestarë paaftësie 80 persona me një fond 859 010 lekë në muaj
- Të verbër 114 persona me një fond 1 393 906 lekë në muaj
- Kujdestarë të verbër 26 persona me një fond 311 090 lekë në muaj.
- Para e tetraplegjike 25 persona me një fond 663 500 lekë në muaj.
- Kujdestarë para e tetraplegjike 25 persona me një fond 276 750 lekë në muaj.
- Kompesim për energjinë elektrike 114 persona me fond 267 744 lekë në muaj.
- Kompesim për telefon 10 persona me një fond 10 000 lekë në muaj.



2. Përfitojne pagesë për shkak Invaliditeti në punë për muajin Dhjetor 2018 në total 346 persona me fond 1 051 200 lekë.

Vendimi u miratua me 14 vota pro , vota kundër – s'ka , vota abstenim- s'ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .



**KRYETARI KËSHILLIT  
PARTIZAN GORÇE**